

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Studimeve Islame
Titulli i lëndës:	Metodologjia e hulumtimit shkencor
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i -I-rë (semestri -I-rë)
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi - ECTS:	5
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Agim Zogaj
Detajet kontaktuese:	Email: agimzogaj@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	Lënda Metodologjia e hulumtimit shkencor trajton pesë faza të veçanta të hulumtimit, si: Të menduarit për hulumtimin; Përgatitja e hulumtimit; Mbledhja e të dhënave; Analiza e të dhënave; si dhe Paraqitja e të dhënave dhe raporteve. Secila fazë është e ndarë në një numër seksionesh të lidhur njëri me tjetrin. Kjo lëndë e trajton hulumtimin empirik si një proces - diçka që është e pandërprerë dhe e vazhdueshme. Gjithashtu lënda përfshinë informacionin se si mendojmë për veten dhe për botën shoqërore, idetë dhe teoritë tona, si dhe aspektet më praktike si hartimi i një pyetësori ose analizimi i statistikave.
Qëllimet e lëndës:	Natyra praktike përbën anën më të fortë të kësaj lënde. Përmes kësaj lënde ne shohim se si i kanë përdorur të tjerët teoritë dhe teknikat e hulumtimit (dhe si ndërveprojnë këto së bashku), çka na ndihmon të kuptojmë se si funksionon bota shoqërore në të cilën jetojmë dhe, pse jo, në ç' mënyrë mund ta ndryshojmë atë; kjo lëndë na ndihmon gjithashtu të mendojmë për mënyrat se si mund ta zhvillojmë hulumtimin.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Nga vijimi i kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> - Të zhvillojnë aftësitë e të menduarit për hulumtim; - Të përgatitin fazat e zhvillimit të procesit të hulumtimit empirik; - Të zbatojnë praktikatat e mbledhjes së të dhënave empirike; - Të konkretizojnë procesin e analizës së të

	<p>dhënave empirike;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të paraqesin pasqyrat e të dhënave empirike; si dhe - Të hartojnë raporte analitike. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	15	15	3.75 orë
Ushtrime në teren	-	-	-
Kolokfiume, seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	10	-	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj	1	1	1
Totali	-	-	133.75 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Procesi i mësimdhënies është interaktiv. Do përdoret teknika e vendosjes së studentit në qendër. Meqenëse natyra e lëndës është praktike atëherë studentët do të jenë të angazhuar vazhdimisht në kryerjen e detyrave praktike në procesin e zhvillimit të hulumtimit, me qëllim të testimit të njohurive të tyre. Ligjërimi do të shoqërohet me parashtrimin e temave për diskutim të cilat kërkojnë shfaqjen e mendimeve nga ana e studentëve. Studentët do të kenë për detyrë që përveç zhvillimit të procesit të hulumtimit të bëjnë edhe prezantimet në klasë.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve në lëndën e Metodologjisë së hulumtimit shkencor, do të jetë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e rregullt = 5% - Aktiviteti në klasë = 5% - Punim seminarik = 15% - Testi i I-rë = 20% 		

	<ul style="list-style-type: none"> - Testi i II-të = 20% - Provimi përfundimtar = 35%
Literatura	
Literatura bazë:	1. Matthews, Bob dhe Liz Ross. Metodatat e hulumtimit. Botues Person Education Limited, 2010.
Literatura shtesë:	1. Adler, Emily and Roger Clark. An Invitation to Social Research. Publishing by Wadsworth USA, 2011.